



Asociacioni i Grave Police të Kosovës
PUNOJMË PËR TË MIRËN E VENDIT!

Prishtinë, Qershor 2013



Pa komunikim nuk ka asnjë
mënyrë me shpreh **mendime,**
ide apo **ndjenja!**



Temat që do të prekën në këtë workshop:

- Qëllimet e komunikimit strategjik
- Qëllimi përfundimtar
- Objektivat e komunikimit të mirëfillët
- Mesazhet Kryesore – Mesazhet e jashtme
- Mesazhet Kryesore – Komunikimi i mbrendshëm
- Mesazhet Kryesore – Komunikim i jashtëm
- Rroli i komunikimit në intervenime dhe gjatë punëve ditore të policisë
- Komunikimi i mbrendshëm
- Strategjitë për komunikim të mbrendshëm
- Rëndësia e komunikimit të jashtëm – me komunitet
- Metodatat tjera të komunikimit
- Komunikimi jo-verbal
- Shenjat jo-verbale të zemërimit
- Qetësimi me anë të shenjave jo-verbale
- Luftoni zemërimin në bashkëbisedim
- Pyetje që duhet përdorur gjatë bashkëbisedimit
- Gënjeshttrat dhe dëshmitë e rrejshme
- Indikatorë të mundshëm verbal të gënjeshtimit
- Indikacionet e mundshëm jo-verbale të gënjeshtres
- Sytë nuk mbajnë sekrete
- Sa jeni të mirë për të gjykuar gënjeshtren?
- Marrje e rrëfimeve
- Rrëfime të pasakta
- Puna me viktimat
- Sjellja me persona ndër efektin e depresionit dhe vetëvrasjes
- Sjellja me persona me tendencë vetëvrasje
- Reagimet e shpeshta ndaj vetëvrasjes
- Metoda për përmirësim të imazhit të grave police dhe ngritje të besueshmërisë në komunitet
- Synimet e Asociacionit të Grave Police Britaneze
- Synimet e Asociacionit Internacional të Grave Police
- Disa synimet tjera të disa Asociacioneve të Grave Police



Komunikimi i grave police ka për qëllim të ndërtojë mirëkuptim për gruan police, për partneritet ndërkolegial dhe institucional, për opercione dhe për parandalim të krimit duke informuar dhe promovuar planet, aktivitetet dhe të arriturat.



Qëllimet e komunikimit strategjik janë:

- Fuqizimi i besimit dhe konfidencialitetit;
- Përmirësimi i pranueshmërisë dhe kënaqësisë publike për punën e gruas police Kosovare;
- Inkurajimi i njerëzve për të ndërmarrë aksione;
- Ngritja e përkrahjes për gruan police Kosovare;
- Të përmirësohet pozita e gruas police Kosovare dhe pozita e gruas në përgjithësi;



Qëllimi përfundimtar është:

Të përmirësohen marrëdhënjet me komunitetin, të punësuarit, palët e interest dhe krijuesit e opinioneve, të cilët do të rrespektojnë integritetin e gruas police, do të pranojnë vlerat, dhe do të kuptojnë fuqitë dhe limitet dhe do të jenë pro-aktiv në shëndrrimin e Kosovës në një vend më të sigurtë.



Aktivitetet e komunikimit nuk mund të ekzitojnë në formë të izoluar. Aktivitetet duhet të jenë të planifikuara me qëllim të fuqizimit të mesazheve kryesore në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme. Ndërsa për gra police, është e rëndësishme të kuptohet frika e njerëzve, brengat dhe aspiratat. Komunikimi efektiv i ndërsjellë është i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve.



Objektivat e komunikimit të mirëfillët janë:

- Kosova të përceptohet dhe të vlerësohet vend i sigurtë për jetesë, punë, vizita dhe për biznes-bërje;
- Komuniteti të jetë i vetëdijshtëm se si gratë police Kosovare parandalojnë dhe zbulojnë krimin dhe punojnë vazhdimisht për përmirësimin e cilësisë së jetesës;
- Të gjithë anëtarët e personelit të jenë të vetëdijshtëm për përgjegjësitë për komunikim efektiv dhe ndikimi i këtij komunikimi në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit;
- Gratë police Kosovare kanë të drejtë në informatë në momentin e duhur për të qenë më efektive dhe të kenë informata për punën e njësiveve tjera;
- Krijuesit e opinioneve dhe palët e interesit të kenë mirëkuptim më të madh për sukseset e grave police Kosovare dhe mjedisin sfidues në të cilin ato veprojnë.



Mesazhet Kryesore – Mesazhet e jashtme

- Parandalimi dhe zvogëlimi i krimit dhe sjellja e krim-bërësve para drejtësisë;
- Gratë police Kosovare veprojnë në bazë të nevojave dhe shqetësimeve të komunitetit dhe për qendër të fokusit kanë qytetarët;
- Do të përgjigjen direkt tek komuniteti pas incidenteve për të siguruar qytetarët;
- Gratë police Kosovare janë të gatshme për t'u përgjigjur në të gjitha llojet e krimit;



Mesazhet Kryesore – Mesazhet e jashtme

- Gratë police për lagje dhe për një Kosovë më të sigurtë. Gratë police në kontakt të përditshëm me qytetarë dhe me komunitetin për të ndëgjuar, për t'u ballafaquar me problem dhe çështje me qëllim të përkrahjes;
- Të jenë efektive, duhet të kuptojmë komunitet të cilave ju shërbejmë, brengat dhe aspiratat e tyre;
- Kuptimi i komuniteteve të ndryshme me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të ndryshme për parandalim dhe luftim të krimit.



Mesazhet Kryesore – Komunikimi i mbrendshëm

- Funkzioni primar është parandalimi i krimit dhe ofrimi i sigurisë për qytetarë;
- Vlerat tona institucionale janë të rëndësishme por aktivitetet tona do të jetësojnë ato. Ato janë të vlefshme për secilin prej nesh;
- Jemi duke përjetuar periudhë ndryshimi;
- Gratë police janë duke bërë punë të vështirë nën rrethana të vështira, por puna jonë duhet të pësojë përmirësimë të vazhdueshme;
- Të gjitha burimet e mbrendshme duhet të përdoren në mënyrë efikase me qëllim të parandalimit dhe pakësimit të krimit dhe parregullsive



Mesazhet Kryesore – Komunikim i jashtëm

- Vazhdimisht me sjelljet tona duhet të përmirësojmë pozitën e gruas në polici si dhe kënaqësinë publike dhe besimin në shërbimin tonë;
- Të gjitha gratë police duhet të punojnë së bashku dhe të kenë rrespekt të ndërsjellë me qëllim që të ndihen të vlerësuara dhe të mburren me aktivitetet e përditshme për parandalim dhe luftim të krimit;



"Zbatimi i ligjit është një nga profesionet e pakta që mund të ndryshojë në mënyrë drastike një personalitet."

Guy Schiller, International Critical Incident
Stress Management Foundation



Gratë police gjatë veprimit duhet të:

- Kenë të gjitha nën kontrollë
- Dëshirojnë të perfomojnë shkëlqyeshëm gjatë detyrës
- Të luftojnë për vazhdueshmëri
- Të kenë motivim të mbrendshëm
- Të jenë të orientuara në veprim
- Të kërkojnë vazhdimisht stimulim dhe të mos mërziten nga puna
- Të kenë përgjigje të menjëhershme
- Të marin rreziqe
- Nevoja për të shpëtuar / të jenë të nevojshme
- Dedikim të lartë



- Të gjitha ndikojne në komunikimin tuaj të jashtëm.
- Të gjitha krijojnë karakterin tuaj dhe me këtë nivelin e komunikimit me komunitetin.
- Të gjitha ndikojnë në efikasitetin tuaj në parandalimin dhe luftimin e krimit.



Rroli i komunikimit në intervenime dhe gjatë punëve ditore të policisë

- Rreth 90% të punëve të organeve të zbatimit të ligjit përfshijnë komunikime me njerëz
- Shumica e intervenimeve përfshijnë marrëdhënje me emocione të intensifikuara me qëllim të marrjes së informatave
- Minuti i parë i interaktivitetit shpesh përcakton drejtimin e bisedës
- Reagimi i njerëzve varet nga sinjalet që marrin nga ju
- Cilësia e reagimit ndikon në reagimet në të ardhmen me ju dhe oficerët tjerë
- Në shumicën e rasteve pjesëtarë të komunitetit parapëlqejnë komunikimin me gra police



Komunikimi i mbrendshëm

Bazë për veprimin kolektiv dhe kuptimin e pengesave dhe arritjeve.

Komunikimi i brendshëm vepron si një bazë për veprim të përbashkët dhe të kuptuarit e pengesat dhe arritjet që përballlet policia në aktivitetet e ditë-për-ditëshme.



Shkëmbim të informacioneve për parandalimin e krimeve

Komunikimi brenda policisë gjithashtu përfshin shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e rëndësishme për parandalime të krimeve.



Strategjitë për komunikim të mbrendshëm

- Komunikim gjatë mbledhjeve – Shpërndarja e detyrave dhe informatave më të rëndësishme të ditës
- Telefonata – Për të kontaktuar departamentet tjera përkatëse
- Radio – Për përforcime dhe shpërndarje të informative gjatë detyrës
- E-Mail – Për shpërndarje të informatave më të hollësishme
- Memorandume – Për shpërndarje të informative informale në zyre
- Publikime të mbrendshme në formë të revistave dhe ose fletushkave



Rëndësia e komunikimit të jashtëm – me komunitet

- Krijimi i marrëdhënieve të mira me komunitetin
- Mbështetje të dyanshme Polici-komunitet
- Krijimi i një harmonie mes dy palëve.



Gratë police duhet të:

- Të jenë transparente dhe të përgjegjshme në llogaridhënie
- Krijimi i mundësive për shkëmbime të njohurisë midis policisë dhe komunitetit.
- Të krijojnë "akademitë policore të qytetarëve" për të edukuar komunitetin me qëllim të ngritjes së vetëdijes për çështje policore.
- Themelimi i takimeve të rregullta të lagjeve ndërmjet policisë dhe anëtarëve të komunitetit.
- Organizimi i forumeve për të diskutuar mbi politikën, taktikat, apo teknologjitë në interes të komunitetit.



Të jenë transparente dhe të përgjegjshme në llogaridhënie

Komuniteti mbështetet mbi departamentin e policisë për të "mbrojtur dhe për të shërbyer" dhe policia, në kthim, mbështetet mbi mbështetjen e komunitetit dhe bashkëpunimit në mënyrë që të jetë efektive.



Të jenë transparente dhe të përgjegjshme në llogaridhënie

Në përpjekjet për të edukuar publikun në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të grave police, sistemet e llogaridhënies duhet të jenë të përshkruara plotësisht. Pyetjet e qarta nga publiku përfshijnë:

- Si funksionon puna e mbrendshme hetimi?
- Cilat janë rezultatet e mundshme të një hetimi të mbrendshëm?
- Kush vendos për ndonjë veprim disiplinor, sjellje të keqe nëse një e tillë është identifikuar?
- A ekzistojnë mekanizmat e jashtëm të mbikqyrjes? Si veprojnë?
- Etj



Krijimi i mundësive për shkëmbime të njohurisë midis policisë dhe komunitetit.

- Një metodë e zakonshme e shkëmbimit të njohurive bëhet përmes “Akademiës Policore të Qytetarëve” për t’u ofruar anëtarëve të komunitetit një mundësi që të përjetojnë dhe kuptojnë më mirë aspektet e punës së grave në polici.
- Akademitë e qytetarëve janë duke u bërë shumë të zakonshme, sepse krijimi i akademive të tilla nga komisarariatet e policisë lejon anëtarët e komunitetit të fitojnë njohuri në politikën e policisë, për taktikat dhe trajnimin. Vlerësohet të jetë zhvillim pozitiv nga komuniteti.



Themelimi i takimeve të rregullta të lagjeve ndërmjet policisë dhe anëtarëve të komunitetit

Takimet e rregullta të planifikuara në baza javore ose mujore përmes oficerëve ndërlidhës si dhe policëve të patrullimit të zonës, i ofrojnë komunitetit lirinë për të shprehur shqetësimet e tyre dhe për të marrë më shumë njohuri për policët që veprojnë në rajonin e tyre.



Metodat tjera të komunikimit

- Pyetësorë për të vlerësuar nivelin e kënaqësisë së komunitetit me performancën e policëve dhe grave police në vecanti
- Video informative për komunitetin
- Forume (të mëdha dhe të vogla) me udhëheqësit e komunitetit si dhe policëve.
- Organizimi i fushatave të ndryshme me qëllim të ngritjes së besueshmërisë në aktivitetet e policisë
- Pjesëmarrja në aktivitete vullnetare në komunitet
- Organizimi i orëve informative në shkolla fillore dhe të mesme në komunitet
- Etj



Komunikimi është shumë i rëndësishëm gjatë kontakteve me komunitetin. Edhe nëse nuk përballeni me ekspertë të vlerësimit të lëvizjeve, këto lëvizje në mënyrë indirekte tregojnë afërsinë tuaj me komunitetin gjatë komunikimit.



Komunikimi jo-verbal

Kontrolloni vetën para se të kontrolloni tjerët

- Zyrtarët, si edhe të gjithë tjerët, mund të bëjnë lëshime jo-verbale që mund të eskalojnë ose komplikojnë situata të ndryshme
- Ushtroni procedurat në mënyrë të vazhdueshme
- Relaksohuni para intervenimeve
- Merrni frymë ngadalë dhe thellë
- Bisedoni qetë me vetën tuaj
- Shikoni mjedisin para se të intervenoni – mos intervenoni në nguti
- Caktoni objektivat para intervenimit
- Gjatë bisedës pauzoni dhe kërkonte nga bashkëbiseduesit të mendojnë për gjërat që keni folur për rreth 1 minutë



Mesazhi mesatarë përbeht nga:

- 7% fjalë
- 55% sjellje fizike
- 38% tonaliteti i zërit



Shenjat jo-verbale të zemërimit

Shenjat e hershme

- prekja e hundës
- qeshja e papërshtatshme (nuk të besojnë)
- kthimi dhe largimi i ngadalshëm (shfaqja e mos-interesimit)
- prekja e pjesë së pasme të qafës (frustrim)
- zvarritja e këpucëve



Shenjat jo-verbale të zemërimit

Shenjat e vonshme

- nivel i lartë i zërit
- fjalim i shpejtë
- frymëmarrje të shkurta
- bie në sy hunda
- luajtja me duar
- fytyra e skuqur



Shembull: Rroli i komunikimit - Rasti i Klinton në cështjen Levinski

Në bazë të studimeve:

- 21 nga 23 indikatorët kanë qenë present, shumica e reagimeve me anë të shenjave të rritura me më shumë se 100%
- Gjatë pjesëve të vërteta ai nuk është përkulur aspak ndërsa gjatë pjesëve të pavërteta është përkulur shumicën e kohës
- Gjatë 16 minutave të dëshmisë së vërtetësisë Klinton nuk ka prekur hundën e tij, por këtë e ka bërë në mënyrë të përsëritur gjatë tregimit të fakteve të pavërteta
- Gabim në fjalime (1733%), belbëzim (1444%), zvogëlimi i lëvizjes së bebëzës së syrit (268%), prekja e fytyrës me dorë (250%), përkulje (100%), mohim (63%)



Qetësimi me anë të shenjave jo-verbale

- Mos qëndroni me duar afër kukut dhe / ose armës tuaj
- Përdorni gjeste me krahë të hapur
- Mos bëni kontakt fizik me njerëz të zemëruar
- Bëni kontakt përmes syve dhe mos shikoni poshtë
- Relaksioni tiparet e fytyrës, buzëqeshni, tregoni përkushtim
- Përdorni tone të buta dhe normale për të zbutur nivelin e zërit
- Lëvizni ngadale
- Mos lëvizni ose mos bisedoni kokë më kokë
- Largoni kapelën
- Le të jenë të gjithë të ulur gjatë komunikimit



Luftoni zemërimin në bashkëbisedim

- Tregohuni e kujdesshme dhe pranoni ndjenjat dhe mbani zërin tuaj në nivel të ulët. Bëni kontaktimin me sy, përdorni emrin e personit.
- Filloni me ndërhyrje të lehta dhe nëse është nevoja, vazhdoni me ndërhyrje të larta.
- Prezantoni alternative të ndryshme. Duke ofruar alternativa ju ofroni rrespekt dhe pranoni nivelin e njejtë të bashkëbisedimit.
- Trajtoni njerëzit në të njejtën mënyrë sit ë rritur edhe në qoftë se sjellja e tyre është fëmijërore. Mos ofendoni dhe / ose poshtëroni bashkëbiseduesin.
- Mos lejoni sjellje abuzuese për të eskaluar situatën.
- Ofroni sugjerime inkurajuese si: “Të ndalemi për një minutë dhe merrni frymë thellë



Luftoni zemërimin në bashkëbisedim

- Duhet të jeni të vetëdijshtëm se ndjenjat e intensifikuara janë pjesë e zgjidhjes së problemeve të vështira.
- Normalizoni ndjenjat nëse jo sjelljen. Bashkëndjeni me bashkëbiseduesin.
- Mbështetuni në pozitën tuaj për të rimarrë kontrollin. Përkujtoni bashkëbiseduesin që është përgjegjësi e juaj që ata të jenë të fokusuar pozitivisht drejt zgjedhjes dhe se ju jeni aty për këtë çështje.
- Keni parasysh dhe rrespektoni kufizimet tuaja. Nëse nuk mund të bashkëbisedoni referoni palën tek dikush tjetër.



Luftoni zemërimin në bashkëbisedim

- Ofroni kohë dhe mos zhvilloni bisedën në nguti. Zakonisht, sa më shumë që bashkëbiseduesi është i zemëruar, më shumë kohë nevojitet për t'u relaksuar. Qëndrimi në qetësi për një kohë të shkurtë mund të jetë e nevojshme, mund të ofroni pushim të shkurtë.
- Mos bisedoni për përmbajtjen deri sa bashkëbiseduesi të qetësohet.
- Të jeni të vetëdijshëm që biseda mund të eskalojë.
- Sigurohuni për sigurinë tuaj. Mos vendosni vetën fizikisht ndërmjet njerëzve të zemëruar. Ofroni urdhëra të shkurtëra dhe relaksuese që ata të ndjehen se kanë kontrollin në bashkëbisedim.
- Mos u ndjeni inferiore për shkak të gjinisë. Jeni të barabartë me bashkëbiseduesin pa dallim gjinie.



Pyetje që duhet përdorur gjatë bashkëbisedimit

- “Pse?” - gjatë marrjes së informatave, ka tendencë të sfidimit, fajësimit ose të pyetjes së bashkëbiseduesit për t’u justifikuar
- “A nuk mendoni se...” - është fjali që ndikon në ndëgjueshmërinë dhe pajtueshmërinë e bashkëbiseduesit
- Pyetje të shumta – kur dy ose më shumë pyetje bëhen në vazhdimësi pa lënë hapësirë për personin që të mendojë dhe të përgjigjet ndikon në frustrimin e bashkëbiseduesit
- “Po ose jo” pyetjet – kjo ngushton sasinë e informatave të marra dhe ndikon në arritjen e përfundimeve



Komunikimi jo-verbal është i një rëndësie të vecantë dhe në mënyrë direkte ose indirekte krijon përshtypje me bashkëbiseduesin. Komunikimi jo-verbal do të ndikojë në arritjen dhe / ose mos arritjen e qëllimeve të bisedimit.

Përdorja e 'truqeve' gjatë bashkëbisedimit përfundon në marrjen e informatave të duhura.



Gënjeshtret dhe dëshmitë e rrejshme

- 60% e njerëzve gënjejnë
- Zyrtarë të policisë dhe pjesëtarë të komunitetit kanë keqkuptime rreth gënjeshtreve
- Zbulimi i gënjeshtreve vlerësohet të jetë më i lehtë për të rinj, gra, dhe njerëz të trajnuar
- Aktorët janë më të mirë se jo-aktorët dhe ushtrimet përmirësojnë gënjeshtren
- Gënjeshtarët e “mirë” mund të përdorin detaje për të bërë tregimet e tyre të vërteta, por mund edhe të kërkojnë detaje, të jenë jo-konsistentë dhe të elaborojnë kohë mbas kohe



Indikatorë të mundshëm verbal të gënjeshtimit


- Zgjerimi i përfundimeve, theksimi i panevojshëm i fjalëve dhe foljeve si “nuk” dhe “nuk mund të”, “mendoja” për të bindur njerëzit se ata janë duke folur të vërtetën.
- Nuk pranojnë gënjeshtren, duke bërë deklarime të buta për të dëshmuar se janë duke treguar të vërtetën si shembull “Nuk kam nevojë të gënjejë”. Pauzimi dhe përdorimi i tingujve pa fjalë hezitues në fjalimin e tyre.
- Gabimi në formulimin e fjalisë (mund të jenë gramatikore, fjalime të tensionuara dhe / ose humbja e mendimit në mes të fjalisë).
- Belbëzimi, hezitimi dhe bllokimi gjatë bashkëbisedimit.
- Përdorimi i fjalëve kualifikuese, modifikuese dhe përshkruese si “sidoqëtëjetë”, “ndonjëherë” dhe “në përgjithësi”



Indikacionet e mundshëm jo-verbale të gënjeshtërs

- Shmangja e kontaktit me sy
- Bashkimi i duarve dhe gishtave
- Kryqimi i krahëve duke krijuar një barrier
- Gëlltitje më e shpeshtuar sesa ata që tregojnë të vërtetën
- Përdorim më i rallë i gjesteve me duar gjatë komunikimit
- Ngritja e supeve dhe rrokullisja e pëllëmbës në mënyrë të hapur
- Prejka e fytyrës, hundës, veshëve
- Kapsimi i syve më pak sesa ata që tregojnë të vërtetën
- Qeshja më e shpeshë në momente të papërshtatshme
- Lëshimi i psherëttimeve dhe frymëmarrja e thellë

Sytë nuk mbajnë sekrete





Marrje të rrëfimeve

- Trillim i simpatisë dhe shoqërisë
- Apel në zot dhe religjion
- Fajëso viktimën apo bashkëfajtorin
- Afrim i tepërt ndaj të dyshuarit, që të ndihet më rehat
- Paraqitje e egzagjeruar e provave
- Pretendimi që një person tjetër ka rrëfyer dhe implikimi i të dyshuarit
- Forma të tjera të mashtrimit
- Intervistim i gjatë deri në momentin kur i dyshuari rrëfen



Rrëfime të pasakta

- 80% e krimeve janë zgjidhur për shkak të marrjes së një rrëfimi, por 5-11% janë bindje të gabuara
- 80% të dyshuarve heqin dorë nga presenca e avokatit gjatë intervistës, të pafajshmit janë më të shpeshë
- Marrjet në pyetje të gjata që përfshijnë pagjumësinë, uritje, përdorimi i kërcënimeve, frikësimi dhe premtime ose stimulime, përqeshja, etj.



Më shumë rrëfime

- Njerëzit të cilët janë të mentalisht të sëmurë mund të rrëfejnë për vëmendje, faj të palidhur, konfuzion, frikësim
- Njerëzit të cilët janë me aftësi të kufizuara, shpesh kanë një dëshirë të fortë për të kënaqur figurat autoritare dhe ndikohen lehtë



Puna me viktima

Intervista me viktima apo të mbijetuarit

Intervista tipike përfshin 4 pyetje të hapura dhe 26 pyetje të mbyllura, të dorëzuara shpejtë!

- Ofro diçka (shembull: pije)
- Dëgjo vazhdimisht
- Shmangju ndërprerjes
- Udhëheq intervistën në ambient të qetë
- Kujdes me prekje
- Mos shpreh nërvozë
- Shpreh kujdes dhe shqetësim
- Vazhdo të sigurosh siguri dhe shoqëri
- Lejo pauza të pyetjeve
- Mos fajëso (me zë, shprehje, ton të zërit)
- Shpreh vlerësim për gatishmërinë dhe përpjekjen e tyre



Sjellja me persona ndër efektin e depresionit dhe vetëvrasjes

Mësoni shenjat:

- Trishtim, mungesa e energjisë
- Bisedim direkt apo indirekt në lidhje me vdekje apo vetëvrasje
- Ndryshime në zakonet e gjumit (shumë apo shumë pak)
- Ndryshim në zakonet e ushqimit
- Dekurajimi për të ardhmen, vetë-kritika
- Mungesa e shqetësimit rreth higjienës dhe pamjes fizike
- Vështirësi komunikimi dhe tërheqja nga kontaktet shoqërore
- Përvetësimi i mjeteve për vetëvrasje (armë, droga, litar)
- Marrja e vendimeve të rrezikshme
- Rritja e përdorimit të alkoholit dhe drogës
- Preokupimi me vdekjen nëpërmjet poezive apo artit
- Përpjekjet e mëparshme për vetëvrasje



Sjellja me persona me tendenca vetëvrasje

- Mos shkarko kërcënim
- Mos jap këshilla
- Mos shkarko faj
- Mos argumento
- Mos ngre moral
- Mos jap siguri te rreme
- Mos sfido
- Mos minimizo arsyet e tyre
- Mos thoni “Unë e di se si ju ndjeheni”
- Mos e vendosni vetën në rrezik



Sjellja me persona me tendenca vetëvrasje

- Përdorni aftësi të mira dëgjuese
- Mos iu shmang temës së vetëvrasjes
- Hiqni mjetet në dispozicion për vetë-lëndim
- Ndhmoni shprehjen e ndjenjave
- Theksojeni dëshirën për të ndihmuar
- Tregoni interes dhe shqetësim
- Pohoni në forcën e tyre për mirëbesim
- Jeni përkrahës dhe pranues
- Bëni një marrëveshje jo-vetëvrasëse
- Kuptoni që jo gjithmonë mund të shpëtoni në vetëvrasës të dedikuar



Reagimet e shpeshta ndaj vetëvrasjes

- Mpirja
- Sëmundje fizike
- Zemërim në viktimë
- Faj
- Frika e përgjegjësisë
- Trishtim, pikëllim, depression
- Lodhje
- Demoralizim
- Humor trekëmbësh



Asociacioni i Grave Police të
Kosovës dhe
Asociacionet e ngjashme në
Botë



Metoda për përmirësim të imazhit të grave police dhe ngritje të besueshmërisë në komunitet

- Organizimi i fushatave për ngritje dhe përmirësim të imazhit të grave në policinë e Kosovës;
- Pjesëmarrje në aktivitetet e komunitetit (të ndryshme si pastrimi i lagjeve, dhurimi i gjakut, aktivitete sportive me banorë të lagjes);
- Organizimi i sesioneve informative në institucione arsimore të arsimit fillor dhe të mesëm;
- Organizimi dhe përfaqësimi në data të ndryshme ceremoniale dhe në aktivitete të ndryshme të organizuara në këto data;
- Organizimi i parakalimeve dhe konferenca në data të dedikuara për gjininë femnore;



Metoda për përmirësim të imazhit të grave police dhe ngritje të besueshmërisë në komunitet

- Organizimi i vizitave të qytetarëve në vendet e ushtrimit si dhe organizimi i vizitave në rajonet policore;
- Organizimi i ditëve të qytetarëve aktiv për mbarëvajtje të trafikut dhe pjesëmarrja proaktive e qytetarëve në zhvillim të aktiviteteve të lehta të sigurisë;
- Shpallja e “Heroinës së Muajit” në baza mujore dhe organizimi i intervistave në televizione lokale;
- Shtypja e informatorit mujorë me informacione rreth aktiviteteve mujore të grave në institucionet e sigurisë në Kosovë;
- Organizimi i trajnimeve profesionale për gra police për konsulencë në çështje më senzitive (shembull: dhuna familjare, dhuna ndaj gruas etj).
- Arritja e marrëveshjeve të mirëkuptimi me asociacione simotra ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të përvojave



Synimet e Asociacionit të Grave Police Britaneze:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e çështjeve që prekin gratë brenda shërbimit policor
- Lehtësimi për kontribim në diskutime mbi çështje me interes të gjithë zyrëtarëve – sigurimi i perspektivës femërore kudo që të jetë e mundur.
- Zhvillimi i një rrjeti të kontakteve profesionale dhe sociale në mes të oficerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë
- Lehtësimi i shkëmbit të informacioneve mbi çështjeve që ndikojnë në shërbim
- Kontributi në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë anëtarëve



Synimet e Asociacionit Internacional të Grave Police:

- Forcimi, bashkimi dhe rritja ndërkombëtare e profilit të femrës në drejtësinë penale
- Gratë të jenë të lira nga diskriminimi
- Vlerësimi për kontributin e tyre
- Trajtimi me respekt dhe dinjitet
- Kontribut duke qenë një shembull i përsosmërisë në sigurimin e një vendpune dhe shoqërie të sigurtë, si partnere në sistemin e drejtësisë penale



Disa synimet tjera të disa Asociacioneve të Grave Police:

- Të përmbajnë shumëllojshmëri
- Të jenë transparente, të ndershme dhe të drejta
- Të dëgjohen anëtarët tjerë
- Të funksionojnë profesionalisht
- Të ndryshojnë për përmirësim



JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!